



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 19.12.2014

Nr.0204-1714

PËR: **Branimir Stojanovic**, Kryetar i Komunës së Graçanicës
 Branka Kostic, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Graçanicës

LËNDA: KONFIRMIMI I LIGJSHMËRISË SË RREGULLORES SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË GRAÇANICËS Nr. Gb-640 të pranuar më datën 11.12.2014

I/E nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Shtojca XII), pas shqyrtimit të Rregullores Nr.Gb-640 të miratuar me datën 09.12.2014 nga Kuvendi i Komunës së Graçanicës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit, dhe vlerëson se e njëjta është në harmoni me Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve.

Akti juridik i cilin prodhon efekt të plotë juridik është si vijon:

- **Rregullore për Përdorimin e Gjuhëve.**

Me respekt,

Ljubomir Maric
Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal

Kopje: *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL*
 Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
 Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 19.12.2014
Br.0204-1714

ZA: Branimir Stojanovic, Gradonačelnik Opštine Gračanice
Brankica Kostic, Predsedavajuća Skupštine Opštine

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE SKUPŠTINE OPŠTINE
GRAČANICA Br.Gb-640 dostavljene dana 11.12.2014

Poštovani/e,

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave, na osnovu nadležnosti i odgovornosti određene u članu 81.4 zakona br.03/L-040 za lokalnu samoupravu, kao i uredbe br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kancelarije premijera i ministarstva (prilog XII), nakon razmatranja uredbe Br.Gb-640 usvojene dana 09.12.2014 od strane skupštine opštine Gračanica, **POTVRĐUJE** zakonitost akta i ceni da je ista u skladu sa Zakonom Br.03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi i Zakonom Br.02/L-37 o Upotrebi Jezika.

Pravni akat koji proizvodi puni pravni efekar je kao sledeće:

- Uredba za upotrebu jezika.

S'poštovanjem,

Ljubomir Marić
Ministar Administracije Lokalne Samouprave

Kopija: *Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a*
Rukovodiocima Odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a

09-640

09-12-2014

Në bazë të nenit 9 paragrafi 2, të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (d) të Ligjit për vetëqeverisje lokale (nr. 03/L-040), të nenit 2 dhe 7 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve (nr. 02/L-37), të nenit 3 të Udhëzimit administrativ për përcaktimin e procedurës për zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve (nr. 2011/02), të nenit 4 dhe 13 paragrafi 13.1 të Statutit të Komunës së Graçanicës (Gb-112 nga 24.04.2013), të Vendimit për njohjen e gjuhës rome (nr. Gb-496 nga 14.10.2014). Kuvendi Komunal i Graçanicës, në mbledhjen e pestë të rregullt të mbajtur më 05.12.2014, ka miratuar të mëposhtme:

RREGULLORE PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

Zbatimi i Rregullores Neni 1

Rregullorja për përdorimin e gjuhëve (në tekstin në vijim: Rregullore) rregullon mënyrën e përdorimit të gjuhëve zyrtare në organet komunale, institucionet dhe ndërmarrjet që janë themeluar nga Komuna e Graçanicës.

Gjuhët zyrtare në Komunën e Graçanicës Neni 2

Gjuhët zyrtare në Komunën e Graçanicës janë gjuha serbe dhe shqipe dhe alfabetet e tyre.

Për gjuhën serbe kryesisht do të përdoret alfabeti cirilik.

Alfabeti latinik i gjuhës serbe ka statusin e alfabetit të barabartë.

Gjuha në përdorim zyrtar në Komunën e Graçanicës Neni 3

Gjuha në përdorim zyrtar në Komunën e Graçanicës është gjuha rome.

Të drejtat e barabarta në përdorimin e gjuhëve zyrtare Neni 4

Të gjithë personat kanë të drejta të barabarta në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare në Komunën e Graçanicës.

Të drejtat në përdorim të gjuhëve zyrtare Neni 5

Çdo person ka të drejtë të komunikojë, të parashtojë kërkesë me gojë dhe me shkrim dhe të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike në cilëndo gjuhë zyrtare.

HYRESHTETËR KENA-INDOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS VLADIKOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data
Datum 11.12.2014
Date

Njësia organizuese	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
-Vt	0208-11/14		

Neni 6

Gjuhët zyrtare përdoren në baza të barabarta në takime dhe në punën e Kuvendit Komunal dhe komiteteve të tij, organeve ekzekutive, si dhe në takime publike të organizuara nga Komuna.

Nëse ekziston ndonjë kërkesë për përkthim gjatë punës së organeve komunale do të mundësohet përkthimi nga një gjuhë zyrtare në tjetrën.

Neni 7

Të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi Komunal (udhëzimet, rregulloret, vendimet dhe aktet e tjera) dhe komitetet e tij, procesverbalet nga takimet publike, si dhe dokumentet e tjera publike do të nxirren dhe publikohen në të dy gjuhët.

Të drejtat në përdorim të gjuhëve të cilat janë në përdorim zyrtar

Neni 8

Personat të cilët iu takojnë komuniteteve, gjuha e të cilave është në përdorim zyrtar kanë të drejtën të paraqesin të gjitha kërkesat dhe dokumentet në formë të shkruar apo gojore, si dhe të pranojnë përgjigjet në gjuhën e tyre nga organet dhe zyrtarët komunalë, nëse ata kërkojnë kështu.

Organi komunal është i obliguar që të vendos për kërkesën e parashtruar brenda 15 ditëve nga data e parashtrimit të kërkesës.

Neni 9

Aktet e marra dhe të miratuara nga Kuvendi Komunal dhe komitetet e tij, organet ekzekutive komunale duhet të publikohen në gjuhën që është në përdorim zyrtar, nëse parashtrohet kërkesa nga ky komitet.

Për kërkesën e parashtruar për përkthim të akteve do të vendoset brenda 15 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Neni 10

Nëse për kërkesën e parashtruar nuk vendoset brenda 15 ditëve, përfaqësuesit e komuniteteve kanë të drejtë të parashtrojnë kundërshtim në Departamentin e administratës së përgjithshme dhe çështjeve të personelit.

Neni 11

Anëtarët e Kuvendit Komunal dhe komitetet e tij kanë të drejtë në përdorim të gjuhës që është në përdorim zyrtar në punën e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, si dhe në takimet publike të organizuara nga Komuna.

Kur ka një kërkesë në formë të shkruar apo gojore, organet komunale janë të obliguar që ta

sigurojnë përkthimin nga një gjuhë zyrtare në një gjuhë tjetër.

Kërkesa për përkthim i parashtrohet kryesuesit të Kuvendit Komunal apo kryetarit të Komunës.

Emrat zyrtare të institucioneve publike dhe vendeve **Neni 12**

Emrat zyrtare të institucioneve dhe të organeve komunale, ndërmarrjeve publike, themeluesi i të cilave është komuna, do të shkruhen në të dy gjuhët zyrtare.

Emrat e organeve zyrtare do të shkruhen në të dy gjuhët zyrtare brenda dhe jashtë objektit në të cilin gjenden organet komunale.

Neni 13

Shenjat zyrtare që shënojnë emrat e komunave, fshatrave, rrugëve dhe të vendeve të tjera publike paraqiten në të dy gjuhët zyrtare.

Përdorimi i gjuhëve në ndërmarrjet publike **Neni 14**

Në ndërmarrjet publike, themeluesi i të cilave është komuna, aplikohet barazia e gjuhëve zyrtare.

Çdo person ka të drejtë të komunikojë, të paraqet kërkesë dhe të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga ndërmarrjet publike në cilëndo nga gjuhët zyrtare.

Personi i kontaktit për gjuhë **Neni 15**

Komuna përcakton një zyrtar si person i kontaktit për gjuhë.

Personi i kontaktit për gjuhë do të bashkëpunojë me autoritetet komunale dhe qendrore, Komisionerin për gjuhë dhe organet dhe organizatat e tjera në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, akteve nënligjore dhe Rregullores për përdorimin e gjuhëve.

Personin e kontaktit për gjuhë e përcakton drejtori i Departamentit të administratës së përgjithshme dhe çështjeve të personelit.

Shërbimi për përkthim **Neni 16**

Shërbimi për përkthim, në kuadër të të cilit punojnë përkthyesit për gjuhët zyrtare, i kryen punët lidhur me përkthimin me gojë dhe me shkrim të dokumenteve zyrtare komunale dhe akteve të

tjera në gjuhët zyrtare në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Shërbimi për përkthim është përgjegjës për cilësinë e shërbimeve të përkthimit.

E drejta për ankesë Neni 17

Çdo person, i cili beson se atij iu është shkelur e drejta për përdorimin e gjuhës zyrtare nga organet komunale, ka të drejtë të parashtojë një ankesë kryetarit të Komunës apo Departamentit të administratës së përgjithshme dhe çështjeve të personelit.

Nëse brenda 15 ditëve nga dita e parashtrimit të ankesës nuk merret përgjigjja nga ana e organeve komunale, personi në fjalë ka të drejtë të paraqesë ankesë Komisionit për gjuhët.

Neni 18

Çdo person, i cili beson se atij iu është shkelur e drejta për përdorimin e gjuhës zyrtare nga organet e ndërmarrjes publike, ka të drejtë t'ia parashtojë një ankesë drejtorit të ndërmarrjes publike.

Njohja e gjuhës si gjuhë zyrtare Neni 19

Pjesëtarët e komuniteteve, gjuha e të cilëve amtare nuk është gjuhë zyrtare në komunë, ndërsa sipas rezultateve zyrtare të regjistrimit përbëjnë së paku 5% të popullsisë së komunës, mund të parashtojnë një kërkesë për njohjen e gjuhës së tyre amtare si gjuhë zyrtare të komunës.

Neni 20

Pjesëtarët e komuniteteve, gjuha e të cilëve amtare nuk është gjuhë zyrtare në komunë, ndërsa sipas rezultateve zyrtare të regjistrimit përbëjnë më shumë se 3% të popullsisë së komunës, mund të parashtojnë një kërkesë për njohjen e gjuhës së tyre amtare si gjuhë zyrtare të komunës.

Neni 21

Pjesëtarët e komuniteteve, gjuha e të cilëve tradicionalisht përdoret në komunë, mund të parashtojnë një kërkesë për njohjen e gjuhës amtare në përdorim zyrtar, pavarësisht nga përqindja e popullsisë së komunës.

Neni 22

Vendimi për njohjen e gjuhës si gjuhë zyrtare merret nga ana e Kuvendit të komunës.

Neni 23

Njohja automatike e gjuhës si gjuhë zyrtare e komunës bëhet pas publikimit të rezultateve zyrtare

të regjistrimit të popullsisë.

Neni 24

Kryetari i komunës informon Kuvendin komunal se cili komunitet përbën më shumë se 3% apo 5% të popullsisë në komunë dhe lidhur me këtë Kuvendi Komunal dhe në pajtim me këtë Kuvendi komunal në mbledhjen e parë të ardhshme do të merr vendim për njohjen e gjuhës si gjuhë zyrtare e komunës.

Neni 25

Nëse Kuvendi komunal në mbledhjen e parë të ardhshme nuk e miraton vendimin për njohjen e gjuhës, pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë kryetarit të komunës.

Kryetari i komunës e informon Kuvendin për ankesën e parashtruar.

Neni 26

Nëse Kuvendi komunal edhe në mbledhjen e ardhshme nuk vendos për njohjen e gjuhës zyrtare, pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë Komisionit për gjuhët.

Neni 27

Pas marrjes së vendimit për njohjen e gjuhës zyrtare, komuna duhet ta harmonizojë brenda 3 muajve Statutin e komunës dhe Rregulloren për përdorimin e gjuhëve me një vendim për njohjen e gjuhës zyrtare.

Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Neni 28

Për zbatimin e kësaj rregulloreje është përgjegjës Departamenti i administratës së përgjithshme dhe çështjeve të personelit.

Neni 29

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për përdorimin e gjuhëve (nr Gb-133 nga 02.06.2011).

Neni 30

Rregullorja hyn në fuqi ditën e marrjes së saj nga Kuvendi komunal, ndërsa zbatohet nga 01 janar 2015.

